

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare
Individuale

Barleti Group Sh.p.k

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Përmbajtje

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Performancës Financiare	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve Monetare	4
Shënimet për Pasqyrat Financiare Individuale	5-23

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Barleti Group Sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Barleti Group Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomali materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të shoqërisë.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare individuale ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

26 korrik 2023


Mediana Kocha, FCPA
Koch




Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar

Shënime	31 dhjetor 2022 (Shuma në LEK)	31 dhjetor 2021 (Shuma në LEK)	Riparaqitje e vitit 2021	
Aktivët Afatshkurtra				
Mjete Monetare	7	1,886,160	27,805,895	27,805,895
Llogari të arkëtueshme	8	1,785,794	439,815	439,815
Llogari të tjera të arkëtueshme	9	20,846,100	15,375,068	15,375,068
Huadhënie afatshkurtër	10	206,655,403	183,570,476	212,725,903
Parapagim te Tatimit mbi fitimin		4,671,662	-	-
Aktive të tjera (libra)	11	6,829,953	5,829,594	5,829,594
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		242,675,072	233,020,848	262,176,275
Aktivët Afatgjata				
Depozita me afat	12	-	12,079,110	12,079,110
Aktive financiare afatgjata	13	1,400,000	1,400,000	1,400,000
Aktivët afatgjata materiale	14	423,489,038	424,498,634	393,878,703
Aktivët afatgjata jo materiale	15	268,293	315,639	315,639
Totali i Aktiveve Afatgjata		425,157,331	438,293,383	407,673,452
Totali i Aktiveve		667,832,403	671,314,231	669,849,727
Pasivët dhe Kapitali				
Detyrimet Afatshkurtra				
Të pagueshme ndaj furnitorëve	16	2,523,954	3,414,173	1,949,668
Të pagueshme ndaj punonjësve	17	11,336,774	9,800,364	9,800,364
Tatim mbi fitimin		-	504,801	504,801
Të ardhura të shtyra	19	46,794,764	35,015,273	35,015,273
Detyrime ndaj institucionit financiar	18	44,626,120	43,714,637	43,714,637
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		105,281,612	92,449,248	90,984,743
Detyrimet Afatgjata				
Detyrime ndaj institucionit financiar	18	152,675,048	196,722,714	196,722,714
Totali i Detyrimeve Afatgjata		152,675,048	196,722,714	196,722,714
Totali i Detyrimeve		257,956,660	289,171,962	287,707,457
Kapitali				
Kapitali i paguar	20	27,000,000	27,000,000	27,000,000
Rezerva ligjore		12,896,363	12,896,363	12,896,363
Fitimet e pashpërndara		312,420,907	262,781,703	262,781,703
Fitimi (Humbja) e vitit financiar		57,558,473	79,464,204	79,464,204
Totali i Kapitalit		409,875,743	382,142,270	382,142,270
Totali i Pasiveve dhe Kapitali		667,832,403	671,314,232	669,849,727

Pasqyrat financiare individuale janë aprovuar nga Drejtimi i më 23 mars 2023 dhe firmosur për llogari të tij nga:


Administrator


Kontabilist

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra Individuale e Performancës Financiare

	Shënime	31 dhjetor 2022 (Shuma në LEK)	31 dhjetor 2021 (Shuma në LEK)
Të ardhurat			
Shitjet neto	21	257,795,078	253,786,318
Te ardhura nga projektet dhe kurset	22	7,148,355	14,477,891
Të ardhura të tjera	23	21,112,633	12,032,306
Totali i të ardhurave		286,056,066	280,296,515
Shpenzimet			
Mallra, lëndë të para dhe shërbime	24	(1,172,670)	(4,135,475)
Shpenzime personeli	24	(148,303,142)	(118,397,472)
Shpenzime të tjera	25	(56,954,580)	(50,283,812)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	14,15	(14,938,292)	(4,948,460)
Totali i shpenzimeve		(221,368,684)	(177,765,219)
Fitimi/(humbja) nga veprimtaritë kryesore		64,687,382	102,531,296
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare:			
Te ardhura nga interesi	12	-	3,110
Shpenzime interesi		(6,616,002)	(6,592,186)
Fitim/Humbje nga kursi këmbimit	26	9,914,393	(1,795,107)
Komisione bankare		(253,798)	(638,661)
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		3,044,593	(9,022,844)
Fitimi/(humbja) para tatimit		67,731,975	93,508,452
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(10,173,502)	(14,044,248)
Fitimi i vitit financiar		57,558,473	79,464,204
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		286,056,065	280,296,515
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		286,056,065	280,296,515

Pasqyra individuale e performancës financiare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali (Lekë)	Rezerva Ligjore (Lekë)	Fitimi i pashpërndarë (Lekë)	Fitimi i vitit (Lekë)	TOTALI (Lekë)
Më 1 janar 2021	27,000,000	12,896,363	289,632,179	-	329,528,542
Rritje e rezervës ligjore	-	-	-	-	-
Shpërndarje Dividendi	-	-	(26,850,476)	-	(26,850,476)
Fitimi/humbja neto i vitit	-	-	-	79,464,204	79,464,204
Më 31 dhjetor 2021	27,000,000	12,896,363	262,781,703	79,464,204	382,142,270
Më 1 janar 2022	27,000,000	12,896,363	342,245,907	-	382,142,270
Rritje e rezervës ligjore	-	-	-	-	-
Shpërndarje Dividendi	-	-	(29,825,000)	-	(29,825,000)
Fitimi/humbja neto i vitit	-	-	-	57,558,473	57,558,473
Më 31 dhjetor 2022	27,000,000	12,896,363	312,420,907	57,558,473	409,875,743

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale.

Pasqyra Individuale e Flukseve Monetare

	Shënime	31 dhjetor 2022 (Shuma në LEK)	Riparaqitje e vitit 2021 (Shuma në LEK)
Fitimi/Humbja para tatimit		67,731,975	93,508,452
Rregullime për:			
Amortizimin	14,15	14,938,292	4,948,460
Rënie/(ritje) në llogari të arkëtueshme	8	(1,345,979)	(421,515)
Rënie/(ritje) në llogari të tjera të arkëtueshme	9	(5,471,032)	(9,132,991)
Rënie/(ritje) në tepicën e aktiveve të tjera	11	(1,000,359)	(930,789)
(Rënie)/ritje në llogari të pagueshme dhe të tjera	16,18	1,485,769	45,062,557
Rritje të pagueshme ndaj punonjësve	17	1,536,410	2,154,134
Rritje në të ardhura të shtyra	19	11,779,491	(12,323,182)
Tatim mbi fitimin i paguar	27	(15,349,965)	(14,941,931)
Mjete Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		74,304,602	107,923,195
Fluksi i parave nga veprimtaria investuese			
Pagesa për huadhënie afatshkurta	9	-	(54,895,872)
Arkëtim nga huatë e dhëna		6,070,499	-
Depozite	12	12,079,110	294,076
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	14	(44,501,279)	(134,150,631)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	15	-	-
Huadhënie afatshkurtër	10		(500,000)
Mjete Monetare neto të përdorura në veprimtari të investuese		(26,351,670)	(189,252,427)
Fluksi i parave nga veprimtaria financuese			
Huaja	18	(44,047,666)	48,246,841
Pagese dividendi		(29,825,000)	(26,850,476)
Mjete Monetare neto të përdorura në veprimtari të financuese		(73,872,666)	21,396,365
Rritja / rënia neto e Mjeteve Monetare	7	(25,919,735)	(59,932,868)
Mjetet Monetare në fillim të periudhës kontabël		27,805,895	87,738,763
Mjetet Monetare në fund të periudhës kontabël	7	1,886,160	27,805,895

Pasqyra individuale e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale.

Shënime për Pasqyrat Financiare Individuale

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Marin Group Sh.p.k ("UMB" ose "Shoqëria") është regjistruar në QKR, me nr. NIPT-i K52115006H. Shoqëria ka filluar aktivitetin e saj në 03.12.2004 dhe organizohet dhe funksionon konform me ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", statutin e saj dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Shoqëria, është licencuar më 12.08.2005 me VKM Nr. 571; ajo ka filluar veprimtarinë në tetor 2005. Universiteti është akredituar institucionalisht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 288, datë 4.09.2009 dhe me Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 9, datë 7.04.2017. UAB është ristrukturuar me miratimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës me shkresën Nr. 2365 Prot., datë 12.04.2006 dhe me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 202, datë 25.05.2015.

Struktura akademike e UMB-së formohet nga dy fakultete dhe gjashtë departamente; struktura e njësive kërkimore formohet nga katër institute dhe dy qendra kërkimore. Në UMB zhvillohen 9 programe studimi (Diploma) Bachelor dhe 19 programe studimi (Diploma) master dhe Programi i Studimit Doktor i Shkencave "Studime Ndërkombëtare për Familjen dhe Komunitetin" i Universitetit Clemson nga SHBA.

Shoqëria Barleti Group Sh.p.k në cilësinë e më cilësinë e mëmës, zotëron 100% të kuotave të Shoqërisë Etno Turizëm sh.p.k, 75% të kuotave të Shoqërisë Human Capital sh.p.k, si dhe 40% të kuotave të Shoqërisë Vitamina Hub sh.p.k.

Shoqëria **Etno Turizëm sh.p.k.**, e themeluar më 8 korrik 2021 nga aksionari i vetëm Barleti Group sh.p.k është vendosur në Tiranë, Shqipëri. Objekti i aktivitetit konsiston në aktivitetin tregtar me qëllime infrastrukturën turistike, logjistikë dhe mikpritje, shërbimi i ushqimit dhe pijeve, rekreacion dhe kohe e lirë, transport dhe udhëtime turistike, si dhe krijimin dhe administrimin e "Qendrës së Kompetencës dhe Ekselencës në Turizëm".

Shoqëria **Human Capital sh.p.k.** e themeluar më 9 tetor 2020 nga Amministrazione Alta Formazione Italia Global Services s.r.l. në bashkëpunim me Barleti Group sh.p.k është vendosur në Tiranë, Shqipëri. Shoqëria përfaqëson një agjenci punësimi ku objekti i aktivitetit konsiston në menaxhimin, fuqizimin dhe aftësimin e kapitalit njerëzor, ndërmjetësimin e punësimit; ofrimin e praktikave dhe intershipëve; ri-integrimin dhe formalizimin në tregun e punës duke përfshirë kategoritë e njerëzve në nevojë.

Shoqëria **Vitamina Hub sh.p.k.** e themeluar më 8 mars 2021 nga Z. Ilir Butka, Z. Dritan Mesareja, dhe Barleti Group sh.p.k është e vendosur në Tiranë, Shqipëri dhe. Objekti i aktivitetit konsiston në multimedia dhe audio vizual, komunikim, marketing dhe reklamim, industri grafike dhe printim, ngjarje artistike, kulturore dhe argëtuese, artet e bukura, arkitekturë, dizajn, dhe projektim, modë, artizanat dhe manufakturë, ekonomia e dijes në industrinë kreative, softuer, harduer dhe elektronika, si dhe shërbime mbështetëse në industrinë.

Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria kishte 193 punonjës përfshirë Administratorin e saj. (2021: 171 punonjës).

2. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur bazuar në koston historike. Shoqëria gjithashtu ka përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara sipas kërkesave të SKK 19 "Kombinimet e Bizneseve dhe Konsolidimi". Pasqyrat financiare të konsoliduara gjenden pranë zyrave qendrore të Shoqërisë.

2.2 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare individuale janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.3 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare individuale, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare individuale duke patur parasysht thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periodat e paraqitura në pasqyrat financiare individuale.

3.1 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Amortizimi vjetor i aktiveve është si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	%
Ndërtesa	5
Makineri dhe pajisje	20
Automjete	20
Pajisje zyre dhe të tjera	20
Komputera dhe pajisje IT	25

Jetëgjatësia e aktiveve dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.3 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.4 Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse në monedhën Lekë dhe Euro.

3.5 Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet fillestar më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet mbi tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

3.6 Zhvlerësimi

(i) Aktivët financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.6 Zhvlerësimi (vazhdim)**(ii) *Aktivët jo financiarë*

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.7 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyre të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.8 Veprimet në monedhë të huaj

Veprimet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi zyrtar i këmbimit për Euro dhe Lekë në fund të vitit paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Kursi Mesatar	Kursi Mesatar	Kursi Mesatar	Kursi Vjetor
EUR	114.23	118.92	120.76	122.44
USD	107.05	113.15	106.54	103.54

3.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

Të ardhurat njihen nëse ka mundësi që të realizohen flukse të ardhshme hyrëse dhe këto flukse mund të maten në mënyre të besueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar në ligjin në fuqi për "Tatimin mbi fitimin" Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin të gjithë barrën për vitin korrent. Tatimi mbi fitimin llogaritet si 15 % e të ardhurave të tatueshme si është përcaktuar në SKK dhe legjislacionin Shqiptar.

3.11 Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë, i cili supozon që Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj në të ardhmen e parashikueshme. Pasiguritë mbi parimin e vijimësisë trajtohen në shënimin 4.

3.12 Përfitimet e punonjësve

Kompania është e detyruar nga legjislacioni aktual shqiptar që të bëjë kontribute fikse në emër të të punësuarve në një fond social që operon nga Qeveria. Të gjitha pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato lidhen.

Pagat, rogat, kontributet ndaj shtetit dhe sigurimet, leja e zakonshme dhe jo, shpërblimet, përfitimet jo monetare (si p.sh shërbimet shëndetësore) janë përlogaritur në vitin kur këto shërbime janë kryer ndaj punonjësve të Shoqërisë.

3.13 Krahasimet

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë janë përgatitur duke u mbështetur në parimin e krahasueshmërisë.

3.14 Kapitali aksionar dhe dividendët

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesi i shoqërisë. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionari i Shoqërisë.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me SKK-të kërkon që drejtimi të bëjë vlerësime, gjykime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm që në varësi të rrethanave besohet të jenë të arsyeshëm, rezultatet e së cilës formojnë bazën për të bërë gjykime rreth vlerave të mbartura të aktiviteteve dhe detyrimeve që nuk janë lehtësisht të identifikueshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësimeve.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur vlerësimi është rishikuar në rastin kur rishikimi ka ndikim vetëm në atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme në rastin kur rishikimi ndikon të dyja periudhat, si periudhën aktuale dhe atë të ardhshme.

Provizionimi i llogarive të arkëtueshme

